



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 32
Prishtinë, më 2. 4. 2009, ora 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujovic, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Mbledhjen e mbikëqyrën: Elita Vokshi dhe Lejla Selimi - OSBE, Driton Vitia - "Infopress"
Rrezarta Ahmeti dhe Driton Selmanaj - KDI.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinatar, zyrtar i lartë dhe Visar Krasniqi zyrtar ligjor.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

- 1 Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 17. 3. 2009 dhe të 24. 03. 2009,
- 2 Miratimi i rekomandimeve të dëgjimit publik, që kanë të bëjnë me petitionin e 125 magjistrave të shkencave të mjekësisë,
- 3 Shqyrtimi i petitionit nr. 03-1641/10-982 dhe i shkresës së H. G nga Podujeva,
- 4 Te ndryshme

Komisioni e miratoi rendin e propozuar të ditës.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 17. 3. 2009 dhe të 24. 03. 2009

Kryetari - Konstatoi se Komisioni i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të 17. 3. 2009 dhe të 24. 03. 2009.

2. Miratimi i rekomandimeve të dëgjimit publik, që kanë të bëjnë me petitionin e 125 magjistrave të shkencave të mjekësisë

Ismet Beqiri – I njoftoi anëtarët për vërejtjet e kërkesës së kësaj çështjeje, me të cilat më shumë do të merrej Senati. Kërkoj të formohet një grupi i përbashkët i punës i Senatit të UP-së dhe i Fakultetit të Mjekësisë, i cili do ta vlerësonte punën, jo në kuadër të punëve të

përditshme, do t'i shqyrtonte problemet e krijuara dhe do të ofronte mundësi përkatëse për zgjidhjen e tyre. Lidhur me këtë pikë i ftoi anëtarët për debat.

Naim Rrustemi – Nëse nuk ka pikë të veçantë dhe konkrete në Statutin e UP-së, e cila duhet të përmirësohet ose të rishqyrtohet, të mos vihet në rend dite. Me këtë punë merret Senati, prandaj nuk ka nevojë për propozime të kësaj natyre. Senati merret me hartimin e ligjeve të UP-së. Dekani i Fakultetit të Mjekësisë përfaqësohet në Senat. Kjo pikë do të ishte fyerje, meqë del se Senati nuk është duke punuar. Sipas tij ligjet duhet të shqyrtohen me kalimin kohës, të caktohen, të konkretizohen e jo vetëm të thuhet se i rekomandojmë.

Nerxhivane Dauti - Tha se me kujdes e ka vlerësuar petitionin. Pas analizave të bërë ka paraqitur disa rekomandime: të shikohet a është respektuar konkursi nga Rektorati, të respektohet radhitja sipas vlerave të kandidatëve dhe të shtohet numri doktorantëve. Ky numër, sipas saj, duhet të ishte 30 e më shumë, të shqyrtohen njësoj të gjitha kërkesat e atyre që kanë konkurruar, sepse ky është kriteri i Këshillit të Universitetit. Kërkoj nga komisionet e tjera që Komisioni të dalë me rekomandime, sepse ndryshe cenohen të drejtat e njeriut.

Ibrahim Makolli – Kërkoj të konkretizohen rekomandimet dhe të fillohet nga e përgjithshmeja. Nëse ka shkelje të rënda, si po flitet në opinion, pse të mos formohet komisioni hetimor parlamentar, i cili do t'i hetonte të gjitha këto raste dhe do ta nxirrte një përfundim. Detyrë e Komisionit hetimor do të ishte të vërtetonte a ka shkelje dhe të marrë vendim.

Sanije Alija – U pajtua me dy propozimet e Nerxhivane Dautit dhe u angazhua për ndryshimin e ligjeve, ngase nuk e rregullojnë drejt gjendjen.

Ibrahim Makolli – Në emër të Komisionit kërkojmë amendamentimin e Ligjit për arsimin e lartë. Nëse vlerësohet se ky ligj i cenon të drejtat e njeriut dhe e pamundëson realizimin e të këtyre të drejtave, atëherë thuhet se Ligji, në këtë pjesë, i cenon të drejtat e njeriut dhe duhet të harmonizohet. Pra, nëse cenohen të drejtat e njeriut, do të kërkoja që Ligji, përkatësisht neni, të amendamentohet, por jo tërësisht. Kjo nuk mund të kërkojë në emër të Komisionit, sepse atë mund ta kërkojë secili individualisht.

Hajredin Hyseni – Lidhur me nismat legjislativë ishte kategorik. Nuk kemi nevojë të merremi me këto nisma. Nëse paraqitet nevoja edhe këtë do ta bëjmë. Propozoi të bëhet harmonizimi i qëndrimeve të Komisionit me komisionet e tjera, të cilat e kanë në shqyrtim të njëjtin petition.

Diskutuan edhe Vezira Emrus, Drita Maliqi, Ibrahim Makolli dhe Nerxhivane Dauti, që kontribuan në hartimin e rekomandimeve. Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv që u zhvillua lidhur me këtë pikë, Komisioni njëzëri miratoi dhe vendosi t'i njoftonte bartësit me këto

R e k o m a n d i m e

1. Kërkojë nga Komisioni përkatës ta bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së konkurseve të viteve 2005 dhe 2009,
2. I rekomandohet Komisionit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, që puna e tij të jetë e afatizuar.
3. Kërkojë të formohet grupi i përbashkët i punës i Senatit të Universitetit të Prishtinës dhe i Fakultetit të Mjekësisë, që të merret me shqyrtimin e problemeve të krijuara dhe të ofrojë zgjidhje përkatëse në përputhje me ligjin.
4. Të bëhet verifikimi i listave të kandidatëve të pranuar.
5. MASHT-i t'i analizojë mundësinë dhe domosdoshmërinë eventuale të

rishikimit të Ligjit të arsimit të lartë të Kosovës, varësisht nga shkalla e zbatimit në Kosovë, ose ta përshpejtojë procesin, nëse ka fillua rishikimi i tij.

4. Te ndryshme

Ismet Beqiri - I njoftoi anëtarët për përfundimin nr. 03-P-086/k, të datës 31. 03. 2009, që e nxori Kryesia e Kuvendit të Kosovës, me të cilin është ngarkuar Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për propozimin e katër anëtarëve të panelit intervistues rekrutues të përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e avokatit të popullit dhe mori këtë

V e n d i m

1. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione i propozon anëtarët nga radhët e veta për formimin e panelit rekrutues të përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e avokatit të popullit:
 - Ismet Beqiri (GP i LDK-së), anëtar,
 - Ibrahim Makolli (GP i AKR-së), anëtar,
 - Shpresa Murati (GP – 7), anëtare,
 - Radmila Vujovic (GP i SLS-së), anëtare
2. Për këtë vendim do të njoftohen anëtarët e emëruar.

Naim Rrustemi – Mos emërimin e avokatit të popullit e vlerësoi të paarsyeshëm. Për këtë shkak është përsëritur konkursi.

1 Shqyrtimi i petitionit nr. 03-1641/10-982 dhe i shkresës së H. G nga Podujeva

Nerxhivane Dauti - Njoftoi për shkresën e paraqitur nga H. G. nga Podujeva, me të cilën është kërkuar të ekzekutohet aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Komunale C. nr. 250/2003. Lidhur me këtë propozoi të nxirret ky

P ë r f u n d i m

Komisioni kërkon nga Drejtoria e Gjeodezisë dhe e Pronës e KK të Podujevës ta zbatojë menjëherë vendimin e Gjykatës Komunale C-nr. 250/2003 për regjistrimin e banesës.

Nerxhivane Dauti - Në cilësi të raportueses, ceku se shkresa nr. 03-1641/D0-982, e datës 4. 2. 2009, e paraqitur nga familjarët e viktimave të terrorit serb, të vrarë dhe të masakruar në fshatin Korishë KK i Prizrenit në vitin 1999 dhe i rekomandoi Komisionit të nxjerrë

P ë r f u n d i m

Familjarët e të rënëve të Korishës së KK të Prizrenit, t'i drejtohen Komunës së Prizrenit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve dhe të pjesëtarëve të UÇK-së, si dhe të familjeve të viktimave civile të luftës.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 00.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri